

Vendim nr. 206 datë 30.09.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 30.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (K) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **KADRI KUKA**, përfaqësuar nga avokat Mehmet Kurti, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 175, datë 26.01.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 1146, datë 17.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2023-4909, datë 16.11.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, pika 1, 43, 44, 52, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 28, 29, 30, 39, 42 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Genti Ibrahim i, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi Kadri Kuka (*kërkuesi*) ka fituar titullin “oficer” me urdhrin nr. 1142, datë 30.06.1984 të ministrit të Mbrojtjes. Kërkuesi ka qenë oficer në strukturat e Ministrisë së Brendshme dhe ka kryer detyra të ndryshme. Në bazë të urdhrit nr. 960, datë 28.07.2008 të ministrit të Brendshëm, në pamundësi për të konkurruar për gradën e radhës, si pasojë e mungesës së funksioneve organike të nivelit të lartë në përputhje me konkurrimin në gradë, kërkuesi mbetet në gradën “major”, si dhe për plotësimin e afatit kohor të qëndrimit në gradë është nxjerrë oficer në rezervë.

2. Në kushtet kur kërkuesi ka qenë efektiv i Gardës së Republikës si oficer në rezervë (ushtarak në reformë), për një periudhë 2-vjeçare, prej datës 31.07.2008 deri në datën 31.07.2010, ai është trajtuar me pagesë kalimtare, duke u paguar me 50% të pagës referuese, me të ardhura mujore në masën e vlerës prej 39.540 (tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e dyzetë) lekësh. Në datën 31.07.2010 marrëdhëniet e tij financiare me Gardën e Republikës janë ndërprerë dhe më 01.08.2010 atij i ka lindur e drejta për pension të parakohshëm. Prej kësaj date ai është trajtuar nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (*DRSSH*), Tiranë, me pension të parakohshëm, të llogaritur sipas dispozitave ligjore të parashikuara nga ligji nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”(ligji nr. 10142/2009) etj.

3. Me urdhrin nr. 464, datë 28.03.2011 të komandantit të Gardës së Republikës “Për përcaktimin e pagës referuese të shtetasit Kadri Kuka, për përfitimin suplementar në çastin e lindjes së të drejtës për përfitim”, për kërkuesin është bërë njësimi i funksioneve organike/gradave gjatë karrierës për efekt të llogaritjes së përfitimit suplementar dhe në përfundim të llogaritjes ai rezultonte me 24 vjet të plota shërbimi aktiv dhe me pagë mesatare mujore 63.531 lekë.

4. Në bazë të vërtetimit të datës 07.02.2013 të komandantit të Gardës, rezulton se funksioni organik “oficer shoqërues banese”, “grupi i shoqërimit të Presidentit të Republikës”, për lindjen e së drejtës së përfitimit suplementar në datën 01.08.2010, njësohet me funksionin organik të nivelit të mesëm “komandant grupi”, nën njësia për ruajtjen dhe mbrojtjen e banesës së Presidentit të Republikës, në njësinë e parë, në Gardën e Republikës, sipas lidhjes nr. 2 të vendimit nr.612, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës, vartësisë strukturore, organike dhe numrit limit të punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë, si dhe për njehsimin e funksioneve organike sipas gradave në strukturë” (VKM nr. 612/2009). Përputhja e gradës me funksionin organik (të njësuar) komandant grupi, nën njësia për ruajtjen dhe mbrojtjen e banesës së Presidentit të Republikës, në njësinë e parë, sipas lidhjes nr. 3 të VKM-së nr. 612/2009, është në limitin n/toger-kapiten.

5. Me shkresën nr. 464/1, datë 28.03.2011 të Gardës së Republikës, kërkuesit i është dërguar praktika për trajtim në DRSSH-në, Tiranë, me qëllim përfitimin suplementar. Në vijim, me vendimin nr. 357, datë 04.04.2011 të DRSSH-së, Tiranë “Për caktim pensioni”, kërkuesit i është lidhur pension i parakohshëm i ushtarakut me periudhë sigurimi 24 vjet, me masë pensioni fillestar 17 585 lekë. Me vendimin nr. 357/1, datë 23.05.2011 të DRSSH-së, Tiranë “Për rishqyrtim pensioni”, për kërkuesin është vendosur lidhja e pensionit të parakohshëm për ushtarakë për 24 vjet sigurimi, me masë pensioni fillestar 18.066 lekë.

6. Pasi është vënë në dijeni për vendimin e mësipërm, në datën 20.07.2012, kërkuesi ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt detyrimin e Gardës së Republikës për të rishikuar dhe ricaktuar njësimin e funksioneve gjatë kryerjes së karrierës për efekt të përlllogaritjes së pagës referuese; detyrimin e Gardës së Republikës për të rivlerësuar vjetërsinë në shërbimin si ushtarak aktiv, për efekt të llogaritjes së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi; detyrimin e DRSSH-së, Tiranë për të rillogaritur dhe paguar pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi; detyrimin e DRSSH-së, Tiranë për të paguar diferencat e papaguara që do të rezultojnë midis pensionit me të cilin është paguar dhe pensionit të rillogaritur, sipas objektit të kësaj padie.

7. Pas shqyrtimi të kërkesëpadisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3223, datë 29.03.2013, ka vendosur pranimin e padisë dhe ka përcaktuar: (i) detyrimin e Gardës së Republikës për të rishikuar dhe ricaktuar kërkuesit njësimin e funksioneve gjatë kryerjes së karrierës për efekt të rillogaritjes së pagës referuese; (ii) detyrimin e Gardës së Republikës për të rivlerësuar vjetërsinë në shërbim si ushtarak aktiv për efekt të llogaritjes së pensionit të parakohshëm të kërkuesit për vjetërsi shërbimi; (iii) detyrimin e DRSSH-së, Tiranë për të

rillogaritur dhe paguar kërkuesit pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas nenit 14 të ligjit nr. 10142/2009; (iv) detyrimin e të paditurës, DRSSH-së, Tiranë, për të paguar diferencat e papaguara që do të rezultojnë midis pensionit me të cilin është paguar kërkuesi dhe pensionit të rillogaritur, sipas objektit të kësaj padie. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim DRSSH-ja, Tiranë dhe Garda e Republikës.

8. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1953, datë 08.05.2014, ka vendosur të shpallë moskompetencën e saj për gjykimin e çështjes civile nr. 1367 akti, datë 21.06.2013 dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit.

9. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2632, datë 01.07.2014, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me arsyetimin se ka shkaqe ligjore për të cilat vendimi i kësaj gjykate është i cenueshëm.

10. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.175, datë 26.01.2015, ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesit, me arsyetimin se ajo nuk gjen mbështetje në ligj dhe prova. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

11. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1146, datë 17.03.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se ajo ka cilësuar saktë faktet dhe veprimet e lidhura me këtë mosmarrëveshje, në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes. Kundër këtij vendimi, në datën 12.04.2017, ka ushtruar rekurs kërkuesi.

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4909, datë 16.11.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk ngre shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Po sipas tij, shkaqet e parashtruara në përmbajtje të rekursit janë të njëjta në përmbajtje me pretendimet e palës paditëse në gjykimin administrativ në shkallë të parë dhe në apel, të cilave iu është dhënë përgjigje përfundimtare prej gjykatës së apelit.

13. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), i cili është regjistruar në datën 07.06.2024, me objekt shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të të tria shkallëve, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

14. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr.8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për

Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuetit

15. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblëdhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

15.1. *Së drejtës së aksesit në gjykatë*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka vlerësuar shkaqet e rekursit dhe nuk ka analizuar pretendimet e kërkuetit.

15.2. *Parimit të kontradiktoritetit, së drejtës për t’u mbrojtur dhe asaj për t’u dëgjuar*, pasi gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar një hetim gjyqësor të cunguar. Kërkuesi i është drejtuar asaj disa herë me kërkesë (në muajin prill 2014) për të detyruar Gardën e Republikës për të paraqitur në seancë gjyqësore disa prova shkresore, konkretisht VKM-të nr. 612/2009; nr. 561, datë 16.08.2006; nr. 621, datë 07.09.2006, të cilat janë tepër të rëndësishme për procesin. Gjykata e shkallës së parë nuk i ka pranuar këto prova shkresore të depozituara nga kërkueti, me argumentin se nuk ishin origjinale. Organika e Gardës së Republikës u konsiderua sekret shtetëror në këtë gjykim nga përfaqësuesi i këtij institucioni, fakt i përforcuar edhe në shkresën zyrtare të komandantit të Gardës së Republikës drejtuar kërkuetit, ndërkohë që një fakt i tillë nuk është i vërtetë.

15.3. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi:

15.3.1. Gjykata e Lartë nuk ka riparuar të metën e gjykimit të gjykatës së apelit, duke mos zbatuar vendimin e Gjykatës nr. 29, datë 31.05.2011.

15.3.2. Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e parashikuar në ligj dhe aktet nënligjore lidhur me vjetërsinë në shërbim për detyrat e kryera, sipas nenit 3, pika 5, të ligjit nr. 10142/2009, kreut II, shkronja “dh”, si dhe pikës 8 të vendimit nr. 793, datë 24.09.2010 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit

të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” (VKM nr. 793/2010) dhe vendimit nr. 561, datë 16.08.2006 të Këshillit të Ministrave “Për pagat sipas gradave për punonjësit, oficerë dhe nënoficerë, të Gardës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (VKM nr. 561/2006). Ajo gjykatë ka cenuar të drejtën e kërkuesit edhe për njësimin funksion-gradë për detyrat e kryera, sipas akteve të mësipërme.

15.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat e faktit nuk u kanë dhënë përgjigje të gjitha kërkimeve sipas objektit të padisë. Po kështu, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se palët kanë konfirmuar se përcaktimi i gradave për t’u njësuar sipas detyrave funksionale të ushtruara bëhet me organikën e Gardës së Republikës, akt i cili nuk rezulton të jetë pjesë e dosjes gjyqësore, ndër aktet e njësuara në formën e rregullt ligjore.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuesit*

16. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

17. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

18. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Kolegji vëren se, ndër të tjera, kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike në lidhje me vendimin e gjykatës së apelit, e cila duhet të ishte riparuar nga Gjykata e Lartë, për shkak të moszbatimit nga ajo gjykatë (gjykata e apelit) të vendimit nr. 29/2011 të Gjykatës. Kolegji konstaton se kërkuesi nuk e ka ngritur këtë pretendim në rekurs dhe për këtë arsye Kolegji çmon se ai nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

20. Pretendimet e tjera, që kanë të bëjnë me cenimin e procesit të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë, të parimit të kontradiktoritetit, së drejtës për t’u mbrojtur dhe së drejtës për t’u dëgjuar, parimit të sigurisë juridike, me argumentet se Gjykata e Lartë ka i ka cenuar kërkuesit të drejtën e parashikuar në ligj dhe në aktet ligjore, lidhur me vjetërsinë në shërbim dhe për njësimin funksion-gradë për detyrat e kryera dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, kërkuesi i ka ngritur, në thelb në rekurs ose janë pretendime ndaj procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor për shqyrtimin e themelit të çështjes. Për rrjedhojë Kolegji vlerëson se për këto pretendime kërkuesi e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive.

21. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor, duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsytuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 40, datë 14.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në rastin në shqyrtim, Kolegji konstaton se procesi gjyqësor është përmbyllur me vendimin nr. 00-2023-4909, datë 16.11.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 07.06.2024. Përmes komunikimit me Gjykatën e Lartë ka rezultuar se vendimi gjyqësor është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 09.02.2024, datë në të cilën palët mund ta dispononin këtë vendim. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se kërkuesi e ka paraqitur ankimin kushtetues individual brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, për rrjedhojë ai legjitimohet edhe *ratione temporis*.

23. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji vëren se, ndër të tjera, kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të kontradiktoritetit, së drejtës për t’u mbrojtur dhe asaj për t’u dëgjuar, me argumentet se gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar një hetim gjyqësor të cunguar. Kërkuesi i është drejtuar asaj disa herë me kërkesë (në muajin prill 2014) për të detyruar Gardën e Republikës të paraqesë në seancë gjyqësore disa prova shkresore, konkretisht VKM-të nr. 612/2009; nr. 561/2006; nr. 621/2006, të cilat janë tepër të rëndësishme për procesin. Gjykata e shkallës së parë nuk i ka pranuar këto prova shkresore të depozituara nga kërkuesi me argumentin se nuk ishin origjinale.

24. Në jurisprudencën kushtetuese është pranuar se në respektim të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 19, datë 01.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar, gjithashtu, se e drejta për t’u dëgjuar është pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor. Kjo e drejtë, në unitet edhe me të drejta të tjera, ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes (*shih vendimet nr. 7, datë 12.03.2010; nr.12, datë 06.06.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, e drejta e mbrojtjes në procesin penal ka përmbajtje substanciale, ajo duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike, dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t’i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimin nr. 35, datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar se gjykata e shkallës së parë nuk i ka pranuar provat shkresore të depozituara nga ai me argumentin se ato nuk ishin origjinale. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se çështjet e interpretimit të ligjit dhe vlerësimit të fakteve dhe provave bëjnë pjesë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, çka nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Kolegji çmon se ky pretendim ka të bëjë me vlerësimin e fakteve dhe provave dhe, si rrjedhim, nuk përbën juridiksion kushtetues. Për më tepër, Kolegji vëren se gjykata e apelit, me vendimin e ndërmjetëm të datës 07.02.2017, ka pranuar kërkesën e tij për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, në prani të palëve, duke riçelur pjesërisht shqyrtimin gjyqësor me qëllim analizimin e provave, pra VKM-ve të mësipërme, në bazë të të cilave kërkuesi pretendonte pranimin e padisë së tij, duke garantuar parimin e kontradiktoritetit, së drejtës për t'u mbrojtur dhe asaj për t'u dëgjuar. Në këtë këndvështrim, Kolegji çmon se ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar, pasi, në rastin konkret, është garantuar kontradiktoriteti i palëve në gjykim.

26. Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e parimit të sigurisë juridike, pasi Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e parashikuar në ligj dhe aktet nënligjore lidhur me vjetërsinë në shërbim për detyrat e kryera, sipas nenit 3, pika 5, të ligjit nr. 10142/2009, kreut II, shkronja "dh", si dhe pikës 8 të VKM-së nr. 793/2010 dhe VKM-së nr. 561/2006. Ajo gjykatë ka cenuar të drejtën e kërkuesit edhe për njësimin funksion-gradë për detyrat e kryera sipas akteve të mësipërme. Për sa më lart, Kolegji konstaton se pretendimi i kërkuesit ka të bëjë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga Gjykata e Lartë, çka nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, ndaj, për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

27. Pretendimet e tjera në drejtim të së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspekt të së drejtës së aksesit në gjykatë dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, Kolegji vlerëson se *prima facie* hyjnë në juridiksionin e kësaj Gjykate. Bazuar në argumentet e parashtruara nga kërkuesi, Kolegji çmon që këto pretendime t'i analizojë në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

28. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e faktit nuk u kanë dhënë përgjigje të gjitha kërkimeve, sipas objektit të padisë. Edhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka vlerësuar shkaqet e rekursit, si dhe nuk ka analizuar pretendimet e tij. Ai ka arsyetuar se palët kanë konfirmuar se përcaktimi i gradave për t'u njësuar sipas detyrave funksionale të ushtruara përcaktohen me organikën e Gardës së Republikës, akt i cili nuk rezulton të jetë pjesë e dosjes gjyqësore, ndër aktet e njësuar në formën e rregullt ligjore.

29. Në jurisprudencën e saj Gjykata e ka vlerësuar të drejtën e aksesit si një të drejtë të individit jo vetëm për të filluar një proces, por edhe për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, përpara së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsyetuar, për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr.17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42 i Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, i cili përkon edhe me detyrimin e gjykatave për të arsyetuar vendimet, sipas nenit 142, pika 1, të Kushtetutës. (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 18, datë 15.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërsa në lidhje me vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë, Gjykata ka theksuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Nën dritën e garancive të parashikuara nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, në vijim Kolegji do të analizojë nëse këto garanci janë vlerësuar e zbatuar drejt, në rastin konkret, nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, vendimet e të cilave janë kundërshtuar nga kërkuesi, pra nëse ato kanë analizuar dhe vlerësuar pretendimet në lidhje me objektin e padisë dhe nëse u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tij.

32. Referuar akteve bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, Kolegji vëren se kërkuksi ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor, duke kërkuar zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje të natyrës administrative, në themel të së cilës kanë qenë pretendimet e tij ndaj palëve të paditura, lidhur me rishikimin dhe ricaktimin e njësitit të funksioneve gjatë karrierës së tij për efekt të përlllogaritjes së pagës referuese, kryerjen e rivlerësimit të vjetërsisë në shërbim si ushtarak aktiv për efekt të llogaritjes së pensionit të parakohshëm, rillogaritjen dhe pagimin e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, si dhe pagimin e diferencave të papaguara ndërmjet pensionit aktual dhe pensionit të rillogaritur, sipas objektit të padisë.

33. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuksit, me arsyetimin se padia e tij nuk gjente mbështetje në ligj e në prova. Lidhur me pretendimin e kërkuksit se grada e tij duhet të ishte “major” sipas pikës 8 të VKM-së nr. 793/2010, dhe jo sipas gradës “kapiten” të dhënë për efekt të njësitit të bërë, ajo gjykatë ka argumentuar se përcaktimi i aktit nënligjor nuk i kapërcen dot në asnjë rast kufijtë e ligjit, i cili në rastin konkret njësimin e gradës ia njeht komandantit të Gardës së Republikës. Po sipas gjykatës së shkallës së parë, kërkuksit i janë vlerësuar në gradën “major” funksionet që ka mbajtur në tre periudhat e fundit të karrierës së tij në Gardën e Republikës. Për më tepër, për efekt të llogaritjes së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas ligjit nr.10142/2009, atij i është marrë për bazë paga referuese, sipas gradës “major”, e cila ka qenë vepruese në kohën e nxjerrjes së tij në rezervë, situatë e cila parashikohet në ligj për përfitimin suplementar sipas ligjit nr.10142/2009 *(shih faqet 14 dhe 15 të vendimit nr. 175, datë 26.01.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë)*.

34. Duke mbajtur qasjen e gjykatës së shkallës së parë, gjykata e apelit ka argumentuar se ajo gjykatë i ka cilësuar saktë faktet dhe veprimet e lidhura me këtë mosmarrëveshje, në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes dhe duke interpretuar ato në mënyrë korrekte. Në lidhje me pretendimin e ngritur nga kërkuksi Kolegji vëren se gjykata e apelit e ka shqyrtuar dhe i ka dhënë përgjigje, duke argumentuar se paga në Gardën e Republikës përcaktohet nga niveli i gradës që zotërohet, ndaj kërkuksi nuk mund të pretendojë një gradë më të lartë për vitet e punësimit të tij, për aq kohë sa në të vërtetë nuk e ka pasur atë, aq më tepër kur edhe pagesat për kontributet dhe sigurimet shoqërore për të janë paguar për një gradë më të ulët nga ajo që pretendon, pra për gradën “kapiten” *(shih faqet 15 e 16 të vendimit nr. 1146, datë 17.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit)*.

35. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012.

Sipas Kolegjit Administrativ, përfundimi i arritur nga gjykata e apelit është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit procedural, ndërkohë që shkaqet e parashtruara në rekurs janë të njëjta në përmbajtje me pretendimet e kërkuarit në gjykimin administrativ në shkallë të parë dhe në apel, të cilave iu është dhënë përgjigje përfundimtare nga gjykata e apelit. Kolegji Administrativ ka arsyetuar se pala rekursuese nuk ka parashtruar asnjë argument shtesë përtej pretendimit fillestar të ngritur në gjykim. Kërkuari nuk ka parashtruar se përse analiza ligjore e rrethanave të faktit dhe zbatimi i ligjit nga gjykata e apelit janë të pabazuara në ligj e prova. Nga ana tjetër, Kolegji ka vënë në dukje se pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave, del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafët 22 dhe 23 të vendimit nr. 00-2023-4909, datë 16.11.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

36. Për sa më lart, Kolegji konstaton se, në rastin konkret, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë analizuar dhe vlerësuar pretendimet e ngritura nga kërkuari për objektin e padisë, duke i dhënë atij përgjigje të arsyetuar dhe duke garantuar kështu të drejtën e aksesit në gjykatë, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

37. Nga ana tjetër, Kolegji vëren se vendimet e gjykatave të faktit evidentojnë qartë rrethanat e çështjes, faktet e pranuar dhe përfundimet e nxjerra prej tyre, si dhe dispozitat ligjore në të cilat ato janë bazuar për zgjidhjen e çështjes në atë mënyrë, duke përmbushur detyrimin e tyre, sipas nenit 142, pika 1, të Kushtetutës për arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Po kështu, vendimi i Kolegjit Administrativ, i marrë në dhomën e këshillimit, nuk cenon të drejtën e aksesit në gjykatë dhe standardin e arsyetimit të vendimit. Ai pasqyron vendimmarrjet e gjykatave të faktit, pretendimet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, Kolegji Administrativ tregon se, pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuari është haptazi i pabazuar, pasi shkaqet e ngritura në të nuk gjenin mbështetje në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012.

38. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

39. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.